



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 707 Prot.

Gjirokastrë, më 03/07/2020

V E N D I M

Nr 24, datë 03.07.2020

**PËR
MIRATIMI I NDRYSHIMEVE NË DOKUMENTACIONIN E APLIKIMIT PËR
PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" NË SHKENCAT
INFERMIERORE**

Në zbatim të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 72, Vendimit nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të"; udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 për Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 20 pika 3, vendimit të njësisë bazë, nr. 24, dt 30.06.2020, vendimit të njësisë kryesore FSHN nr. 4, datë 01.07.2020 dhe në përgjigje të emailit zyrtar të MASR-së të datës 26.06.2020 me subjekt : "Njoftim mbi mangësitë e konstatuara nga ekspertët", protokolluar në universitetin "Eqrem Çabej" me nr. 656 prot, datë 24.06.2020, Senati Akademik diskutoi rreth këtyre mangësive / rekomandimeve të ekspertëve dhe propozimeve të ardhura nga Njësia Kryesore dhe Njësia Bazë mbi ndryshimet në dosjen e aplikimit për këtë program studimi dhe në mbledhjen e tij të datës, 03. 07. 2020;

V E N D O S I :

1. Të miratojë ndryshimet në dokumentacionin e aplikimit për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në Shkencat Infermierore sipas materialit drejtuar Senatit Akademik bashkelidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e këtij vendimi i përcillet strukturave përkatëse.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEMA

